



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**

Nr. Prot. 836 Datë 23/9/2015

**AUTORITETI I MEDIAVE
AUDIOVIZIVE**

Nr. Prot. 1883 Datë 23/9/2015

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale i përfaqësuar nga **Komisioneri, z. Besnik DERVISHI** (që këtu e më poshtë “KDIMDP”) dhe **Autoriteti i Mediave Audiovizive** i përfaqësuar nga **Kryetari, z. Gentian SALA** (që këtu e më poshtë “AMA”).

Duke vlerësuar rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale në veprimtarinë e mediave audiovizive,

Duke u angazhuar për garantimin dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në veçanti në fushën e të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale gjatë përpunimit të të dhënave, që zhvillohet si pasojë e veprimtarisë së transmetimeve audiovizive,

Palët bien dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (“Marrëveshja”).

Neni 1

Baza ligjore

Kjo marrëveshje bazohet në të drejtat dhe detyrimet e palëve të përcaktuara në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Ligjin nr. 146/2014 “Për njoftim dhe konsultim publik” dhe në Ligjin nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2

Objekti

Objekti i kësaj marrëveshje është institucionalizimi i marrëdhënieve midis palëve për aplikimin e procedurave dhe sigurimin e ndihmës reciproke në drejtim të lehtësimit të shkëmbimit të informacionit e bashkëpunimit midis dy institucioneve, që thjeshtojnë bashkëpunimin e ndërsjellët të tyre në kuadër të garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për vendosjen dhe garantimin e zbatimit të rregullave të së drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale në fushën e mediave audiovizive dhe elektronike.

Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

KDIMDP dhe AMA angazhohen të bashkëpunojnë ngushtësisht me njëri-tjetrin, por në mënyrë të veçantë:

1. Palët angazhohen të bashkëpunojnë nëpërmjet shkëmbimit të mendimeve, sugjerimeve, informacionit dhe praktikave, që prekin objektin e veprimtarisë së palës tjetër.
2. Palët angazhohen të bashkëpunojnë në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare, që i shërbejnë zbatimit të ligjeve përkatëse.
3. Palët angazhohen të shkëmbejnë në mënyrë të vazhdueshme njohuri dhe praktika të reja.
4. Palët angazhohen të caktojnë personat përgjegjës për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në ligjet përkatëse.

Neni 4

Të drejtat

Me qëllim përmbushjen e objektit të kësaj marrëveshje, palët kanë të drejtë:

1. Të marrin pjesë në takime të grupeve të punës të organizuara nga secila prej tyre.
2. Të marrin pjesë në aktivitete të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare, që i shërbejnë zbatimit të ligjeve përkatëse, veçanërisht në trajnime dhe takime pune me nëpunësit e dy institucioneve dhe autoriteteve përgjegjëse.
3. Të organizojnë shkëmbime profesionale përmes formimit tekniko-juridik e profesional, në funksion të veprimtarisë përkatëse.

Neni 5

Detyrimet e palëve

Secila nga palët nënshkruese angazhohet në ndjekjen e objektivave dhe detyrimeve të kësaj marrëveshje si më poshtë vijon:

1. Të institucionalizohet, sipas kësaj marrëveshje dhe akteve normative në fuqi në Republikën e Shqipërisë, bashkëpunimi reciprok në përmbushje të detyrimeve ligjore të ndërsjellta në sferën e forcimit të mbrojtjes së të dhënave personale në fushën e mediave audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse.
2. Të bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë punën për hartimin dhe rishikimin e programeve të transparencës, si dhe të japin kontributin e tyre në kryerjen e sondazheve në lidhje me çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me të drejtën e informimit.
3. Të bashkëpunojnë dhe të koordinojnë punën për hartimin e kodit/kodeve të etikës, të mediave audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse, sipas përcaktimeve ligjore përkatëse.
4. Të bashkëpunojnë për të bërë propozimet, në kuadër të përmirësimeve ligjore e nënligjore në fushën e të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale.
5. Të nxisin sensibilizimin e opinionit publik me qëllim rritjen e ndjeshmërisë për mbrojtjen e të dhënave personale në fushën e mediave audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse.
6. Të koordinojnë dhe bashkëpunojnë me shoqatat e subjekteve audio dhe/ose audiovizive, për rritjen e përgjegjësisë dhe të standardeve profesionale të gazetarëve dhe punonjësve të tyre, me shoqatat për mbrojtjen e fëmijëve, për koordinimin dhe zhvillimin e veprimtarive të përbashkëta, për të minimizuar rastet e shkeljeve të të dhënave personale të fëmijëve në programet audio dhe/ose audiovizive.
7. Të koordinojnë punën për të institucionalizuar bashkëpunimin efikas me organizmat dhe shoqatat ndërkombëtare që operojnë në Shqipëri, për mbrojtjen e privatësisë, veçanërisht për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Neni 6 Personi i kontaktit

1. Palët në zbatim të kësaj marrëveshje do të caktojnë nga një person kontakti.
2. Personat e kontaktit do të mbajnë vazhdimisht takime ndërmjet tyre, në varësi të nevojës për shkëmbim informacioni, si dhe do të informojnë titullarin e institucionit në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshje.
3. Komunikimi mes palëve do të jetë në formë zyrtare shkresore, duke mos përjashtuar format më të shpejta të komunikimit.
4. Palët do të njoftojnë menjëherë në rast se ndryshohet personi i kontaktit.
5. Në dhe për zbatim të kësaj marrëveshje, personat e kontaktit do të jenë:
 - a. Për KDIMDP-në Redi Skënderaj,
 - b. Për AMA-n Alma Dervishaj.

Neni 7 Marrëveshja dhe ndryshimet

Kjo marrëveshje përbën të vetmen marrëveshje midis Palëve në lidhje objektin e saj.

Çdo shtesë a ndryshim i saj do të bëhet vetëm me shkrim dhe do të fillojë efekte juridike vetëm pas nënshkrimit nga palët.

Asnjë amendament ose ndryshim tjetër i marrëveshjes nuk do të jetë i vlefshëm pa qenë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht marrëveshjes dhe të nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i palëve.

Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët, sipas marrëveshjes, duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 8 Mirëbesimi

Palët do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjellë.

Palët duhet të mbajnë në mirëbesim të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të shkëmbyera prej tyre në lidhje me këtë marrëveshje.

Neni 9 Dispozitat e fundit

1. Palët marrin përsipër respektimin dhe zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje.
2. Marrëveshja hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj dhe do të zbatohet me afat të pacaktuar. Në rast ndryshimi të kushteve që kanë diktuar nënshkrimin e saj, palët do të paraqesin dhe miratojnë ndryshimet përkatëse të kësaj marrëveshjeje.
3. Marrëveshja përpilohet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen pranë KDIMDP-së dhe dy të tjera pranë AMA-s.

Palët lexojnë, kuptojnë, pranojnë dhe nënshkruajnë këtë marrëveshje, duke pranuar kështu kushtet e saj, në dhe për interes të qëllimeve që përfaqësojnë.

Për

**Komisionerin e të Drejtës për Informim
dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**



Për

**Autoritetin e Mediave
Audiovizive**

